



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 178/2023
Datë: 19 / 09 / 2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.05/L-118, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Komisioni *Ad hoc* për pranimin dhe transferimin e rasteve dhe të dhënave tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përmbartimore që gjenden në zyrën përmbartimore të ish-përmbartuesit privat z. Ilir Mulhaxha, në këtë përbërje:

- 1.1. Labinot Gashi, DPL/MD, kryesues;
- 1.2. Mimoza Blakaj, DPL/MD, anëtar;
- 1.3. Besnik Aliu, OPP, anëtar.

2. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi që lëndët dhe të dhënat e tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përmbartimore që është në zhvillim e sipër si dhe lëndët e përfunduara në zyrën e ish-përmbartuesit privat z. Ilir Mulhaxha, të pranuar, t'i transferoj në mënyrë proporcionale tek Përmbartuesit Privat të emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

3. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi që në kohën e pranimit dhe transferimit të lëndëve dhe të dhënave të tjera që ndërlidhen me procedurën përmbartimore të ftoj që të jenë prezent edhe përmbartuesit privat nga pika 2 e këtij vendimi.

4. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, që me rastin e pranimi dhe transferimit të lëndëve dhe të dhënave tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përbarimore përkatëse të mbaj procesverbal.

5. Komisioni fillon punën nga dita pasuese e pranimi të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

6. Me hyrjen ne fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 86/2023, dt. 28.03.2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 94/2023, dt. 03.04.2023 dhe Vendimin nr. 170/2023, dt. 15.08.2023.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Përmbauesit Privat, z. Ilir Mulhaxha;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Odës së Përmbauesve Privat;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Departamentit për Profesione të Lira;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.